



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1960/7 prot

Datë 16.09.2025

V E N D I M
Nr. 1254/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-50351-06-05-2025, me objekt: “Implementim i Software per Financen dhe Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LACONICS” SHPK në procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kavaje, me adresë: Shëtitorja “Josif Bundo”.

Ankimues:

“DATA LOG” SHPK, me NIPT (L32402003S), me adresë: Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Deshmoret e Kombit, Kulla 2, kati 4, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: “Idealdevs Corporation” SHPK, me NIPT (M38106801F), me adresë: Fier Ballsh DRENOVE BARAJ 01960008" Nd. 64, H. 1. 2

“LACONICS” SHPK, me NIPT (M02325002F), me adresë: Rruga Hoxha Tahsim, aktualisht Rruga Manol Konomi, Zona Kadastrale 8150, Pasuria Nr.2/543+1-37.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.06.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-50351-06- 05-2025, me objekt: “Implementim i Software per Financen dhe Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.

II.2. Në datën 24.06.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 16.07.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-“IDEALDEVS CORPORATION” SHPK	8,750,900 lekë	kualifikuar
2- “LACONICS” SHPK	9,375,000 lekë	kualifikuar
3- “DATA LOG” SHPK	9,445,000 lekë	kualifikuar
4-“INFOSOFT SYSTEMS&InfoSoft Business Solutions” shpk	10,210,667 lekë	kualifikuar
5-“HELIUS SYSTEMS” SHPK	11,400,000 lekë	kualifikuar
6-“MC NETEÖORKING” SHPK	11,800,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 17.07.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraparak, i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 22.07.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/5590 dhe me nr. 1960/2025 datë 22.07.2025 e operatorit ekonomik “DATA LOG” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-50351-06- 05-2025, me objekt: “Implementim i Software per Financen dhe Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK dhe mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LACONICS” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1960/1, datë 23.07.2025.

II.7. Me shkresën nr. 1428/5 prot, datë 31.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1960/2 prot datë 04.08.2025 me objekt: “*Informacion*” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimii të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës si më poshtë vijon:

“Ankesa mbi kriterin 1.1.1. Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te viteve 2022, 2023 dhe 2024, leshuar nga Administrata Tatimore, me vlere jo me te vogel se vlera e parshikuar e kontrates. Ne zbatim te nenit 43, pika 3, te VKM nr.285, date 19.05.2021 kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar mesiper. Kur oferta paraqitet nga nje bashkim operatoresh. ky kriter plotesohet nga secili anetar i bashkimit ne raport me perqindjen dhe/ose elementet qe men- persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit.

Ne lidhje me ankesen mbi kriterin 1.1.1, sqarojme se AK eshte bazuar ne piken 3 te nenit 77 te ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet “3. Ne lidhje me situaten ekonomike

dhe financiare. autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten. Per keti qellim autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne ne veçanti qe operatoret ekonomike te kene nje xhiro vjelore minimale te caktuar. Gjithashtu. autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore qe te tregojne raportet ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale qe kerkohet nga operatoret ekonomike nuk mund te tejkalohet dyfishin e vleres se parashikuar te kontrates. Kur nje kontrate ndahet ne lote, ky nen zbatohet per çdo lot individual. Megjithate. autoriteti ose enti kontraktor mund te percaktojte xhiron vjetore minimale qe u kerkohet operatoreve, duke iu referuar grupeve te loteve. ne rast se ofertuesi i suksesshiem merr disa lote qe duhet te zbatohen ne te njejten kohe. Ne rastin e kontratave qe bazohen ne nje marreveshje kuader, kerkesa per xhiron minimale llogaritet mbi bazen e permasave maksimale te kontratave specifike qe do te zbatohen ne te njejten kohe ose, kur permasat nuk dihen, mbi bazen e vleries se parashikuar te marreveshjes kuadër”, dhe per plotesimin e kriterit eshte e shprehur qarte se kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar. Kerkesa per vertetimin e xhiros vjetore ne vetvete nuk nenkupton vitet e eksperiences se operatorit ekonomik, se sa kapacitetin financiar per te realizuar nje sherbim te caktuar.

OE i renditur i pari “Idealdevs Corporation” shpk ka dorezuar prane Autoritetit Kontraktor vertetimin e xhiros vjetore dhe pas vleresimit te KVO, bazuar ne vleren e xhiros te vitit 2023 dhe 2024, kriteri konsiderohet i permbushur, sikurse parashikohet edhe ne piken 3 te nenit 43 ku citohet se “Kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te paktien nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

Ligji dhe aktet nenligjore per prokurimin publik nuk parashikojne qe operatoret ekonomike te duhet te kene nje numer minimal vitesh ne treg, pervec rasteve kur kjo kerkohet ne menyre te qarte ne DST, çka nuk eshte rasti ne kete procedure. Po ashtu, shkalla e nderlikimit te objektit eshte vleresuar nga Autoriteti Kontraktor ne momentin e hartimit te DST, permes perkufizimit te kriterëve perkatese teknike dhe financiare. Çdo operator qe permbush keto kriterë, konsiderohet ne gjendje te realizoje objektin e kontrates me cilesine dhe standardet e kerkuara. dhe nuk mund te penalizohet per shkak te viteve te eksperiences ne treg.

Per sa me siper, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 1.1.1 nuk qendron.

Ankesa mbi kriterin 1.1.2. *Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve 2022. 2023 dhe 2024 te paraqitura ne Administraten Tatimore dhe te konfirmuara prej tyre, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve neni 41, pika “c”, te Ligjit nr. 10091, date 5.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar”, i ndryshuar. Ne zbatim te nenit 43, pika 4, te VKM nr.285. date 19.05.2021, kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga nje bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anetar i bashkimit.*

Ne lidhje me ankesën mbi kriterin 1.1.2, *sqarojme se referuar dokumentacionit fizik te paraqitur nga OE “Idealdevs Corporation” Shpk, ku ka dorezuar kopje te noterizuar te bilancit te vitit 2024 te certifikuar me vulen e tatimeve dhe ekspertit kontabel, rezulton se ka te ardhura me medha se fondi limit i procedures tenderuese, gje e cila rrit besueshmerine per Autoritetin Kontraktor per realizimin me sukses te kontrates. Ne zbatim te nenit 43, pika 4, te VKM nr.285/2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar ku citohet “Nese vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund te kerkoje qe operatoret ekonomike te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore, per nje periudhe maksimumi tre vitet e fundit financiare, qe te tregojne raportet, ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nese kerkohen nje ose dy bilance, kerkesa konsiderohet e permbushur nese ne bilancin/et e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit”, kjo kerkese eshte konsideruar e permbushur nga OE “Idealdevs Corporation” shpk pasi ne bilancin e dorezuar per vitin 2024 nuk ka nje raport negativ mes aktivitetit dhe pasivitetit. Ne zbatim te ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave nr.5, date 30.01.2006, “Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, VKM-se Nr. 922 date 29.12.2014 “Per deklarimin e detyrueshem te deklaratave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet forrnes elektronike”, ligjit Nr. 25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore”, Ne kreun III, neni 10, ky ligj percakton se:*

“Çdo subjekt i cili kryen nje biznes, me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8.000,000 (tete milione) leke, i nenshtrohet detyrimit te pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel”.

Sipas kesaj dispozite, çdo subjekt i cili gjate vitit fiskal realizon te ardhura mbi 8,000,000 leke, nuk eshte me subjekt i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin, por i tatimit mbi fitimin.

Me tej, per vitin 2023, OE eshte klasifikuar ne kategorine e biznesit te vogel pasi nuk permbush kushtin per tejkalimin e xhiros dhe si rrjedhoje, nuk ekziston detyrim ligjor per deklarimin e detyrueshem te Pasqyrave Financiare ne Drejtorine Rajonale Tatimore ku subjekti ushtron aktivitetin apo pasqyrimin e detyrueshem te ketyre pasqyrave ne QKB.

Per sa me sipër, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 1.1.2 nuk qendron.

Ankesa mbi kriterin 2.3.1. *Per te provuar pervojen e meparshme, operatorët ekonomike duhet te paraqesin deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 40% e fondit limit te kesaj kontrate. Per te provuar pervojen e meparshme, duhet qe:*

- a. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik si deshmi per pervojen e meparshme te paraqiten vertetim i realizimit me sukses dhe faturen tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore. ku shenohen datat, shumet dhe sasite e mallrave te furnizuara.*
- b. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat si deshmi per pervojen e meparshme te paraqiten fatura tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumet dhe sasite e mallrave te furnizuara.*

Kur oferta paraqitet nga nje bashkim operatorsh, ky kriter plotesohet nga secili anetar i bashkimit ne raport me perqindjen dhe/ose elementet qe merr persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit.

Ne lidhje me ankesen mbi kriterin 2.3.1. *sqarojme se: OE “Idealdevs Corporation” Shpk, per plotesimin e ketij kriteri ka dorezuar faturat tatimore nr. 10/2024 dhe 05/2025, te leshuara me date 12.07.2024 dhe 22.02.2025, te deklaruar ne organet tatimore me vlere me te madhe se 40% e fondit limit te kesaj procedure tenderuese te realizuara ne sektorin privat per sherbime te ngjashme me objektin e prokurimit, siç parashikohet edhe ne piken 3 te nenit 41 te VKM 285/2021 ku citohet “Ne rastin e pervojes se mëparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, te plotësuar sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumet dhe shërbimet e realizuara”.*

Duhet theksuar se kerkesa per pervoje te ngjashme, siç percaktohet ne kriterin 2.3. 1 te DST, nuk ndalon qe vlere e kerkuar te permbushet nepermjet nje apo disa kontratave, publike ose private, per sa kohe dokumentacioni perkates (faturat tatimore te deklaruar) verteton permbushjen e vleres se kerkuar (ne kete rast, jo me pak se 40% e fondit limit).

OE ka paraqitur dokumentacion te sakte dhe te vlefshem per kontrata te realizuara ne sektorin privat. duke plotesuar vleren e nevojshme. OE ka dorezuar gjithashtu kontraten e nenshkruar me “Bashkine Devoll” nr. 2190 prot.. me objekt “Implementim programi per sistemin e taksave dhe te ardhurave vendore”, e cila verteton se subjekti ka krijuar nje pervoje te tille edhe ne sektorin publik edhe pse nuk eshte kriter i detyrueshem per proceduren objekt prokurimi. Pervoja ne sektorin privat eshte ne menyre te qarte e pranueshme ne perputhje me piken 3 te

nenit 41 te VKM nr. 285/2021. Prandaj, analiza vetem mbi kontratat publike nuk eshte e mjaftueshme per te perjashtuar apo skualifikuar nje operator nga gara.

Per sa me siper, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 2.3.1 nuk qendron.

Ankesa mbi kriterin 2.3.2. Operatori Ekonomik duhet te jete i autorizuar nga prodhuesi dhe te **kete** te pakten nje punonjes nga stafi teknik i OE qe eshte i certifikuar nga Prodhuesi i vepres te cilin eshte duke ofruar. Sistemi i propozuar duhet te kete te pakten nje implementim te meparshem ne vend me te gjithë modulet e kerkuara ne kete DST. Punonjesi i certifikuar duhet te figuroje ne listpagesa te pakten per periudhen Mars-Maj 2025.

Sistem i regjistruar ose Sistem i gatshem (I testuar si i gatshem ne pervoja te ngjashme te vertetuar).

Ne lidhje me ankescn mbi kriterin 2.3.2, sqarojme se: Operatori Ekonomik ka dorezuar deklaraten e prodhuesit, ne te cilen ka deklaruar se eshte prodhuesi i sistemit te taksave dhe tarifave vendore E- Tais, mbrojtur me marken tregtare nr. 25844 date 20.02.2025, ne fushen e teknologjise se informacionit nga Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale.

Po ashtu bashkangjitur ka dorezuar certifikaten e trajnimit date 25.01.2025 te punonjesit Ernado Selami, i cili rezulton ne listepagesen e muajit Mars - Maj 2025 te shoqerise.

OE ka dorezuar gjithashtu kontraten e nenshkruar me "Bashkine Devoll" nr. 2190 prot., me objekt

"Implementim programi per sistemin e taksave dhe te ardhurave vendore" per te vertetuar sistemin e gatshem per implementim.

Ne kushtet qe OE eshte vete prodhues i sistemit dhe ka te vertetuar me marken tregtare te leshuar nga instuticionet perkatese. ky kriter konsiderohet i permbushur.

Per sa me siper, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 2.3.2 nuk qendron.

Pas analizes se dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik "LACONICS" shpk dhe krahasimit me kriteret e percaktuara ne dokumentet standarde te tenderit, komisioni konstaton dhe vlereson pretendimet e operatorit ekonomik "DATA LOG" shpk te paraqitura ne ankesen e tyre, si me poshte:

Ankesa mbi kriterin 2.3.1. Per te provuar pervojen e meparshme, operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 40% e fondit limit te kesaj kontrate. Per te provuar pervojen e meparshme, duhet qe:

- a. Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për pervojën e mëparshme të paraqiten vërtetimi i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b. Ne rastin e përvijës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për pervojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementet që merr persipër të realizojë secili prej anëtareve të bashkimit.

Ne lidhje me ankesën mbi kriterin 2.3.1, sqarojmë se: OE "LACONICS" shpk, për plotësimin e këtij kriteri ka dorëzuar fatura tatimore nr. 48/2014; nr.38/2024; nr.30/2024; nr. 26/2024; nr.11/2024, nr.3/2024; nr.57/2023; nr.47/2023; nr.45/2023; nr.36/2023; nr.29/2023; nr.63/2024; nr.10/2024

nr.59/2024; dhe nr.32/2025, të verifikuara edhe në platformën qeveritare të faturave tatime.gov.al (efiskalizimi-app.tatime.gov.al), të deklaruara në organet tatimore me vlerë me të madhe se 40% e fondit limit të kësaj procedure tenderuese të realizuara në sektorin privat për shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, siç parashikohet edhe në piken 3 të nenit 41 të VKM 285/2021 ku citohet: “Në rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara “.

Duhet theksuar se kërkesa për pervoje të ngjashme, siç përcaktohet në kriterin 2.3. 1 të DST, nuk ndalon që vlera e kerkuar të përmbushet nepermjet një apo disa kontratave, publike ose private, për sa kohë dokumentacioni përkatës (faturat tatimore të deklaruara) vertetohet përmbushjen e vlerës së kerkuar (në këtë rast, jo më pak se 40% e fondit limit).

OE ka paraqitur dokumentacion të saktë dhe të vlefshëm për kontrata të realizuara në sektorin privat, duke plotësuar vlerën e nevojshme. OE ka paraqitur gjithashtu kontratën e nënshkruar me “Bashkinë Vore” nr. 2579/4 prot., datë 20.05.2024 me objekt “Blerje sistemi i integruar i menaxhimit të taksave publike për Bashkinë Vore” si dhe kontratën nr.22 prot., datë 06.01.2025 me objekt “Shtimin e

funksionaliteteve për Sistem të Integruar të Planifikimit, Grumbullimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave Vendore” me Bashkinë Vore, e cila vertetohet se subjekti ka krijuar një pervoje të tillë edhe në sektorin publik edhe pse nuk është kriter i detyrueshëm për procedurën objekt prokurimi. Pervoja në sektorin privat është në mënyrë të qartë e pranueshme në përputhje me piken 3 të nenit 41 të VKM nr. 285/2021. Prandaj, analiza vetëm mbi kontratat publike nuk është e mjaftueshme për të përjashtuar apo skualifikuar një operator nga gara.

Per sa me sipër, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 2.3.1 nuk qendron.

Ankesa mbi kriterin “2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi dhe të ketë të paktën një punonjës nga stafi teknik i OE që është i certifikuar nga Prodhuesi i vepres, të cilin është duke ofruar. Sistemi i propozuar duhet të ketë të paktën një implementim të mëparshëm në vend me të gjithë modulet e kerkuara në këtë DST. Punonjësi i certifikuar duhet të figurojë në listpagesa të paktën për periudhën Mars-Maj 2025.

Sistemi i regjistruar ose Sistemi i gatshëm (I testuar si i gatshëm në përvojë të ngjashme të vertetuar)”.

Në lidhje me ankesën mbi kriterin 2.3.2, sqarojmë se: Operatori Ekonomik "LACONICS.. shpk ka bërë vetedeklarim në përputhje me pikën 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, deklaratë e nënshkruar dhe vëlosur nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Admiring Kala, i cili mban përgjegjësi të plotë ligjore për vertetimin e të dhënave, dokumentacionit të paraqitur dhe çdo deklarami të bërë në këtë dokument. Duke qenë se OE nuk është shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi, dokumentacioni origjinal nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori Ekonomik ka dorëzuar Certifikatë Konformiteti, Nr.certifikatë CERN/CESSE/23642024, Standarti:ISO/IEC 20001 :2014, për specifikat e produktit: Platforma e Planifikimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave Vendore, datë certifikimi 22.02.2024 dhe datë skadence 21.02.2027.

Po ashtu bashkangjitur ka dorëzuar deklaratat mbi disponueshmërinë e anetareve të stafit, gjithsej 4 anetare, të cilët rezultojnë në listpagesën e muajit Mars-Maj 2025 të shoqërisë.

OE ka dorëzuar gjithashtu kontratën e nënshkruar me “Bashkinë Vore” nr. 2579/4 prot., datë 20.05.2024, me objekt "Blerje sistemi i integruar i menaxhimit të taksave publike për Bashkinë Vore" si dhe kontratën nr. 22 prot., datë 06.01.2025 me objekt “Shtimin e funksionaliteteve për Sistemi të Integruar të Planifikimit, Grumbullimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave Vendore” me Bashkinë Vore për të vertetuar sistemin e gatshëm për implementim.

Në kushtet që OE është vetë prodhues i sistemit dhe ka të vertetuar me markën tregtare të leshuar nga institucionet përkatëse, ky kriter konsiderohet i përmbushur.

30. Për sa më sipër, KSHA arsyeton se pretendimi mbi kriterin 2.3.2 nuk qendron.

Sa më sipër, KVO ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur online të sjellë nga operatorët ekonomikë “Idealdevs Corporation” shpk (edhe fizikisht, pasi është shpallur fitues paraprak) dhe “LACONICS” shpk duke dalë në rezultatin që plotësojnë kriteret e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Per kete arsye dhe sa eshte argumentuar me siper. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, bazuar ne nenin 114/3. germa c), te Ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr.285/2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, vendosi:

VENDOSI:

1. Refuzimin e ankeses se shoqerise “DATA LOG” shpk, me objekt: Shfuqizimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave per kualifikimin e ofertave te paraqitura nga operatoret ekonomike “Idealdevs Corporation” shpk dhe “LACONICS” shpk..”

II.8. Me shkresën nr. 1960/3 prot, datë 02.09.2025 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Data Log” SHPK”, është përcjellë tek autoriteti kontraktor kërkesa për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik, duke kërkuar dokumentacionin fizik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “DataLog” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën nr. 3782/2 prot, datë 11.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 1960/4 prot datë 15.09.2025 me objekt: “Kthim Përgjigje” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar mbi trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua se Pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk është paraqitur formular argumentash nga subjekti i interesuar “, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “DATA LOG” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatori ekonomik “Laconicss” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentin se: “LACONICS shpk me NUIS M02325002F është krijuar si shoqëri më 24.11.2020, nuk plotëson kriterin teknik që kërkon: “2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të

provuar përvojën e mëparshme, duhet që: a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara Sipas të dhënave zyrtare në : https://openprocurement.al/sq/tender/list/corporate_id/M02325002F mbi sisteme të ngjashme dhe kontrata publike të realizuara për qeverisjen vendore rezulton se ky OE ka gjithsej 5 kontrata ku vlera totale e tyre është: “4,834,000 lek pa TVSH” ku ndër to vetëm 4 kanë objekt të ngjashëm me procedurën objekt ankimi ku serish kriteri i pasjes së 40% të fondit limit nuk përmbushet, gjë që do të conte në skualifikimin e këtij OE për mospërmbushje të këtij kriteri teknik të rëndësishëm për të provuar eksperiencën të ngjashme konform LPP në mënyrë që një OE të shpallet fitues. Neni 2, qëllimi i ligjit 162/2020, LPP, parashikon shprehimisht se: qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.2.1 dhe 2.2.2 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “LACONICS” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Kontrata_te_ngjashme_Kontrata_me_ministrine

-Kontrata_te_ngjashme_Eurosig

-Kontrata_te_ngjashme_Fatura_Intesa_San_Paolo_Bank

Nr. Fatures	Data fatures	Vlera pa tvsh
48	7/1/2024	xxxxxxx
38	6/11/2024	xxxxxx
30	5/2/2024	xxxxxx
26	4/2/2024	xxxxxx
11	2/1/2024	xxxxxx
3	1/3/2024	xxxxxx
57	12/1/2023	xxxxxx
47	11/1/2023	xxxxxx
45	10/5/2023	xxxxxx
36	9/4/2023	xxxxxx
29	8/1/2023	xxxxxx
63	8/19/2024	xxxxxx
10	1/19/2024	xxxxxx

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së mëparshme të ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur e fondit limit të kësaj kontrate. KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 9 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shërbimin objekt prokurimi. KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me implementimin e Software-ve për Financën dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohej, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes,

të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.9. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “Data Log” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Laconicss” SHPK se nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 9 e DT, (*“Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisht e mallrave të furnizuara. b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisht emallrave të furnizuara. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.”*). Komisioni, referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE konkretisht fatura tatimore të shitjes pasi kreu verifikimet rezulton se operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE faturat me të dhëna si më poshtë: Numri i faturës: 48, datë 7/1/2024 Shërbim programimi;; Numri i faturës: 38/2024, Shërbim programimi; Numri i faturës: 30/2024, Shërbim programimi; Numri i faturës: 26/2024 Shërbim programimi, Numri i faturës: 11/2024 Shërbim programimi ; Numri i faturës: 3/2024, Shërbim programimi; Numri i faturës: 57/2023, Shërbim programimi; Numri i faturës: 47/2023, Shërbim programimi; Numri i faturës: 45/2023 Instalim, Shërbim programimi; Numri i faturës: 36/2023, Shërbim programimi; Numri i faturës: 29/2023, Shërbim programimi; Numri i faturës: 63/2024, Advance Payment for Software Development; Numri i faturës: 10/2024, Advance Payment for Software Development. KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së kontratave dhe faturave të dorëzuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kontratat dhe faturat e paraqitura janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pra janë realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (09.06.2025). Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, dhe kontratave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik e “Laconics” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të shitjes, dhe

kontratave të dorëzuara dëshmon, se ka kryer furnizime të natyrës së shërbimit objekt prokurimi, sikurse janë Implementim i Software. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave dhe kontratave, rezulton se këto (faturat dhe kontratat) konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, kontratat e paraqitura janë të natyrës “Shërbim programimi, Blerje sistem i integruar i menaxhimit të taksave publike, Shtim i funksionaliteteve për sistem të integruar të planifikimit, Grumbullimit, dhe menaxhimit të të ardhurave vendore”, pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit. Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së faturave dhe kontratave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “Laconics” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se vlera e realizuar është ajo që kërkohet në kriterin kualifikues. Sa më sipër Komisioni vëren se nga verifikimet e kryera të dokumentacionit të faturave të ngarkuara në SPE nga operatori ekonomik “LACONICS” shpk janë të plotësuara të tre komponentët kumulative në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Laconics” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme të ngjashme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik pasi rezulton se nga objekti i faturave punë të ngjashme si dhe nga përlllogaritja e tyre shumat totale të çdo faturë kriteri rezulton i përmbushur nga operatori ekonomik.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “DataLog” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “LACONICS” shpk, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentin se: *“Sa i përket kriterëve të tjera të kualifikimit si “Operatori Ekonomik duhet të jete i autorizuar nga prodhuesi dhe të kete të pakten nje punonjes nga stafi teknik i OE qe eshte i certifikuar nga Prodhuesi i veprës të cilin eshte duke ofruar. Sistemi i propozuar duhet të kete të pakten nje implementim të mëparshëm në vend me të gjithë modulet e kerkuara në kete DST. Punonjesi i certifikuar duhet të figuroje në listpagesa të pakten për periudhën Mars-Maj 2025” kërkojmë nga KSHA dhe KPP të verifikojnë nëse ky kriter është përmbushur apo jo nga ky OE (LACONICS shpk me NUIS M02325002F).”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ankimuesi nuk ka parashtruar asnjë fakt apo dyshim për këtë ofertues. Referuar VKM nr. 766, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullores *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe *“elementet e domosdoshëm të ankesës”* sipas përcaktimeve të nenit 48, *“Kushtet formale të ankesës”*, pika 3. *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a. provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni i Prokurimit Publik;*”. Përsa më sipër operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkak të

ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kriteresh, ndaj dhe pretendimet e operatorit ekonomik “DataLog” sh.p.k përsa i përket operatorit ekonomik “Laconics” sh.p.k nuk do të merren në shqyrtim nga KPP.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “DataLog” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Laconics” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” Shpk, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.3.1. Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin.

III.3.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që përpara tij me vlerë më të ulët vijon të qëndrojë i kualifikuar një operator ekonomik edhe pas ankesës së bërë prej tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi

për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Laconics" SHPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik "Laconics", SHPK do të vijojë të mbetet i kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s'kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Idaldevs Corporation" shpk, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operatorë ekonomik pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës..

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *"Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *"DataLog"* SHPK për procedurën e prokurimit *"E hapur"*, me Nr. REF-50351- 06-05-2025, me objekt: *"Implementim i Software per Financen dhe Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore"*, me fond limit 12,500,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavaje.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik *"DataLog"* SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

